

Akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Prime Press Albania” sh.p.k.

I mbajtur sot, të martën, më datë 04.06.2024, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi të RSh-së, në ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private e të privatizimit”, në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt themelimi ortakët: individë me përgjegjësi të kufizuar, banues në Tiranë, vendosin të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Prime Press Albania” sh.p.k. me akt themelimi siç vijon:

NENI 1 **(Formulimi dhe emërtimi)**

Emërtimi i shoqërisë është “Prime Press Albania”, i ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “sh.p.k.”, i cili përfaqëson dhe formën juridike të saj. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit shqiptar në fuqi, ndërsa degët, filialet apo zyrat e përfaqësisë do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të kenë selinë. Shoqëria do ta ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë, i cili do të miratohet nga ortakët themelues.

NENI 2 **(Marka, vula dhe shenja identifikuese)**

Shoqëria do të ketë markën identifikuese të saj me madhësi të zakonshme, së bashku me tekstin shoqëruar. Shoqëria ka vulën e saj.

NENI 3 **(Selia e shoqërisë)**

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: rruga “Aleksandri i Madh”, lagjja nr. 14, Astir, Tiranë 1061, Shqipëri. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë apo të krijojë filialet brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 4 **(Objekti i veprimtarisë)**

Shoqëria ka si objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve, që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë territorit të saj. Objekti i veprimtarisë konsiston në:

- përfaqësimin ekskluziv të shtëpisë botuese “Prime Press” në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.
- përfaqësimin e enteve të tjera botuese shqiptare apo të huaja, në varësi të ecurisë së shoqërisë.
- shitjen me pakicë e shumicë, import-eksport, shpërndarjen e librave dhe të materialeve shkollore.
- trajnime, konsulencë, workshop-e, sesione informuese për mësuesit, nxënësit, studentët apo palët e tjera të interesuara.
- organizimin e konferencave, seminareve apo prezantimeve të ndryshme me karakter komercial.
- konsulencë akademike

NENI 5
(Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë)

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar.

NENI 6
(Kapitali themeltar i shoqërisë)

- Kapitali themeltar i shoqërisë është i barabartë me: **60.000,00** (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
- Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota, secila me vlerë nominale 30.000,00 (tridhjetë mijë) lekë.
 1. Z. Armando KORÇARI zotëron **1 (një) pjesë** ose **50%** (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.
 2. Znj. Eda CAULI zotëron **1 (një) pjesë** ose **50%** (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.
- Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
- Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (pa kaluar nën limitin e vlerës fillestare të lejuar me ligj).

NENI 7
(Drejtimi dhe organet e shoqërisë)

Shoqëria do të drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm (administratori i shoqërisë), i cili është dhe përfaqësues ligjor i saj. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me palë të treta dhe ka kompetenca të plota siç parashikohen në statutin e shoqërisë. Çdo kontratë/marrëveshje do të kryhet prej tij, dhe në rast mungese, nga ortakja tjetër e shoqërisë **znj. Eda Cauli** ose një përfaqësues tjetër i autorizuar me prokurë prej tij.

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë do të jetë **z. Armando Korçari** për një periudhë **4-vjeçare** me të drejtë ripërtëritjeje.

Organet kryesore të shoqërisë janë: - Drejtori i Përgjithshëm (Administratori i shoqërisë)
-Asambleja e Përgjithshme (Asambleja e Ortakëve)

NENI 8
(Fitimi dhe të ardhurat)

Të ardhurat neto të shoqërisë u takojnë ortakëve që posedojnë aksionet e saj.

NENI 9
(Emërimet)

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë për vlera materiale, financiar për pasqyrat financiare të shoqërisë apo likuidator të mundshëm për problemet që mund të ketë shoqëria në vazhdim.

NENI 10
(Shndërrimi i formës ligjore të shoqërisë)

Shoqëria mund ta ndërrojë formën e saj ligjore nëpërmjet kalimit të saj në shoqëri aksionare (Sh.A.).
~~Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj palëve të treta.~~

NENI 11
(Mosmarrëveshjet)

Konfliktet apo mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti, do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit në fuqi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 12
(Hyrja në fuqi dhe zbatimi)

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” si dhe me legjislacionet ndërkombëtare apo konventat ndërkombëtare në të cilat është pjesë Republika e Shqipërisë.

Shoqëria fiton personalitet juridik prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të QKB-së sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.

NENI 13
(Dispozita përfundimtare)

Ky akt themelimi u përpilua në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë juridike për t’u administruar në bazë të ligjit, një kopje për t’u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga një kopje për ta mbajtur secili nga ortakët dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “Prime Press Albania” sh.p.k..

Për shoqërinë “Prime Press Albania” sh.p.k.

Ortakët bashkëthemelues

Z. Armando KORÇARI

Armando Korçari



Znj. Eda CAULI

Eda Cauli



Tiranë, më 04 qershor 2024